


A. MURADINI
09.08.2017
A.K. —

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren
197/4
09.08.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	09.08.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 197/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	<i>FÉR</i> Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.61/2017 të dt. 26.07.2017 për lëndën Fatmir Godeni Nr. 04-353/01-60293 për mbindërtimin dhe shtim ndërtimin e objektit – shtëpisë individuale, në ngastrën kadastrale Nr.2302-3 Z.K. Prizren.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



INSTITUT I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE
INSTITUT ZA ZAŠTITU SPOMENIKA
THE KOSOVO INSTITUTE FOR THE PROTECTION OF MONUMENTS
Nr. 406 08.08.2017
PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 61/2017
Datë: 26.07.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i kërkesës/projektit për mbindërtimin e katit të dytë dhe shtim ndërtimin e shtëpisë individuale për banim në ngastrën kadastrale Nr. 2302 – 3 Z. K. Prizren.
2. Në bazë të rekomandimit dhe arsyetimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues i cili duhet të shqyrtohet dhe aprovohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e zyrtarëve profesional nga Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Fatmir Godeni nga Prizreni ka parashtruar kërkesen për mbindertimin e katit të dytë dhe shtim ndertimin e shtëpisë individuale për banim në ngastrën kadastrale me numër 2302-3. Etazhiteti i objektit ekzistues është P+1, ndësa etazhiteti i ri parashihet të jetë P+0. Objekti që do të ndertohet gjendet në zonën e VI-të sipas planit të konservimit ku etazhiteti i lejuar është P+2 (lartësia maksimale deri te streha është 9.5 m) dhe për ndertim mund të shfrytëzohet deri 60 % e sipërfaqës së parcelës. Në afërsi të parcelës ku do të ndertohet objekti nuk ka ndonjë monument që gjendet në listën e MKRS.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, konkludoi se shtimi/ mbindërtimi është brenda kritereve të Planit për Konservimin dhe Zhvillimin e Qendrës Historike të Prizrenit, dhe si i tillë aprovon projektin.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së perkatëse;
- Komunës perkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM – së;
- Arkivit të IKMM – së;
- Arkivit të MKRS – së;

